



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 5192 Më 24.08.2023
Br. prot. Dt. 24.08.2023
RAHOVEC - ORAHOVAC

Procesverbal i Dëgjimeve për Buxhetin e vitit 2024 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026 *në* Sallën e Kuvendit

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2024 dhe KAB-in për vitet 2024-2026, u publikua me datë: 28.07.2023 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/07/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-PUBLIKE-ME-QYTETARE-PER-BUXHETIN-E-VITIT-2024.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

*Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, nenit 6 pika 1.3, i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komuna, Rregullores Komonale për Transparencë me Nr. Prot. 2697, njoftojmë se nga data: **14.08.2023** deri me datë: **18.08.2023** nën organizimin e Drejtorisë për Financa dhe Buxhet dhe anëtarëve të Grupit punues për hartimin e Projekt-Buxhetit të Komunës së Rahovecit, do të organizohen njëmbëdhjetë (11) dëgjime publike buxhetore.*

Dëgjimi publik me Qytetaret e Lagjeve 1, 2, 3, 4, dhe 5 në Qytet, për planifikimin e buxhetit për vitin 2024 dhe KAB-in për vitet 2024-2026.

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendar i dëgjimeve buxhetore për njëmbëdhjetë (11) dëgjimet buxhetore në komunën e Rahovecit në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/07/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-PUBLIKE-ME-QYTETARE-PER-BUXHETIN-E-VITIT-2024.pdf> më datë: 28.07.2023.

Po ashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar OJQ-të, Bizneset dhe Grupet e Interesit, Buxhetimi Gjinnor ku janë janë të informuar edhe gjinia **femërore**, si dhe Bashkësitë Lokale dhe lagjet urbane përfaqësuesit të shkollave dhe rininë, rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilin vendbanim, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit buxhetor me Qytetaret e Lagjeve 1, 2, 3, 4, dhe 5 në Qytet, u publikua më datë 10.08.2023 në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/08/Njoftim-per-mbajtjen-e-degjimit-publik-per-buxhetin-e-vitit-2024-lagjet-ne-Rahovec.pdf>

Njoftimet, përveç që janë publikuar në ueb-faqe të Komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social *Facebook*, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale *Viber dhe WhatsApp*.

DËGJIMI PUBLIK ME Qytetaret e Lagjeve 1, 2, 3, 4, dhe 5 në Qytet

Dëgjimi buxhetor me Qytetaret e Lagjeve 1, 2, 3, 4, dhe 5 në Qytet, u mbajt më: 18.08.2023, në Sallën e Kuvendit Rahovec, me fillim në orën **14:00**.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim nga Grupi punues dhe zyrtarë komunalë, ishin: 7

- Femra ishin: 1
- Meshkuj ishin: 6

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 24

- Femra ishin: 5
- Meshkuj ishin: 19

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Dëgjimën e shpalli të hapur drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, Afrim Limani.

Afrim Limani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar qytetarë të Lagjeve 1, 2, 3, 4, dhe 5 në Qytet, ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu!

Jemi sot këtu ne dëgimet buxhetore, për të marrë kërkesat tuaja si q Qytetaret e Lagjeve 1, 2, 3, 4, dhe 5 në Qytet, prioritetet që ju keni dhe më pas t'i harmonizojmë në planifikimin që bëhet për vitin 2024.

Buxheti për vitin 2024 do të jetë: 20,034,785.00 euro, **Paga dhe mëditje** në vlerë prej 10,300,983.00 euro, **Mallra dhe Shërbime** në vlerë prej 2,466,340.00 euro, **Shërbime Komunal** në vlerë prej 370,000.00 euro, **Subvencione dhe Transfere** në vlerë prej 890,000.00 euro, si dhe **Investimet Kapitale** kapin vlerën prej 6,007,462.00 Euro.

Ju lus që kërkesat edhe pasi t'i paraqisni këtu, me shkrim dhe të protokolluara t'i sillni dhe në Komunë, që më pas të cedohen nëpër drejtoritë përkatëse. Urdhëroni ju të nderuar Qytetarë të Lagjeve 1, 2, 3, 4, dhe 5 në Qytet.

Teki Mustafa, Rahovec: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Rregullimi i varrezave të viktimave të luftës, gjithsej 38 varre,
- Ndërtimi i rrugës te fabrika e plastikës, a është bërë zgjidhja e kontekstin,

Gazmend Iska, Rahovec: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Rregullimi i ndriçimit publik te Lumi Duhlo (mirëmbajtja, sepse ka prishje prej personave të pandërgjegjshëm,

Naim Kafexhiu, Rahovec: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Rruga "Sadedin Hajda" - mungon trotuari, sepse aty kalojnë nxënësit edhe është shumë i nevojshëm rregullimi i këtij trotuari.

Ajet Cena, Rahovec: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Rruga “Luftëtari”, deri te Tranziti lartë, afër 100 metra rregullimi i kësaj rruge me kubëza.

Afrim Limani: Faleminderit Qytetarë të Lagjeve 1, 2, 3, 4, dhe 5 në qytet që jeni prezent dhe keni paraqitur kërkesat tuaja!

Mirë u takofshim!

Dëgjimi publik përfundoi në orën: 14:40

Rahovec, 18.08.2023

Ekrem Bytyçi
Kryesues i Grupit Punues